



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 328/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa A.nr.328/2019 e datës 06.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, dhe koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike - vendosjes së posterit në afërsi të shkollës fillore, "Zenel Hajdini", në Komunën e Ferizajit, në ditën e votimit, i SHQIPOHET gjobë në lartësi prej 1,500.00 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën shumë, detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 06.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.328/2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se më datë 06.10.2019, në ditën e zgjedhjeve, në afërsi të shkollës fillore, "Zenel Hajdini", në Komunën e Ferizajit, është parë poster i subjektit politik AAK&PSD, me kandidatë për deputet, veprim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës, bie në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2013, përkatësisht nenin 3, pika 3.4 të kësaj rregulle, duke shtuar se pavarësisht faktit se komuna, këto vende i ka paraparë si vende në të cilat mund të vendosen posterët, ato janë pranë shkollave, brenda perimetrit 100 metërsh, dhe janë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret. Paraqitësi i ankesës si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të printuar, në cilësi të provës materiale.

PZAP-i, konform nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, njoftoi koalicionin AAK&PSD, për ankesën e paraqitur ndaj tyre, me afat për përgjigje deri më datë 07.10.2019, në ora 13:00, mirëpo deri në këtë kohë nuk u pranua asnjë përgjigje nga ana e tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 2, të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë nga paraqitësi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit me kandidatë për deputet nga radhët e koalicionit AAK&PSD, është vendosur në hapësirë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 3 pika 3.4, të

Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, e cila përcakton se: *“Materialet e zgjedhjeve nuk duhet të vendosen brenda hapësirës së institucioneve publike, shkollave, objekteve fetare ose objekteve në pronësi shtetërore, në monumente, ndërtesa, struktura dhe objekte të cilat kanë vlerë historike, kulturore, fetare ose arkitekturore, brenda ndërtesave dhe zyrave të KQZ-së dhe brenda qendrave të votimit ose në një largësi prej më pak se njëqind (100) metrash nga hyrja e tyre”*, si dhe nenin 36 par.1, pika a) dhe b), të LZP-së, e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë: a) Shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga qendrat e votimit ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit; b) Bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Duke u nisur nga gjendja faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit AAK&PSD, është shkelur dispozita e lartëcekur e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, pasi që posteri me kandidatë për deputet nga radhët e koalicionit AAK&PSD, është vendosur në hapësirë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjektet politike të koalicionit AAK&PSD, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë njoftuar me Rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti posteri i kandidatëve për deputet nga radhët e koalicionit AAK&PSD, është vendosur në hapësirë publike.

Si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që koalicionit AAK&PSD, i dha mundësinë për tu përgjigjur në ankesë dhe për tu deklaruar për pretendimet ankimore, mirëpo koalicioni AAK&PSD, nuk dha ndonjë përgjigje lidhur me pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës dhe as nuk ofroi ndonjë dëshmi se nga ana e këtij subjekti politik janë ndërmarrë veprime në drejtim të evitimit të shkeljes, gjë kjo e cila ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, në kuptim të nenit 35 paragrafi 2, nenit 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullës Nr. 01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjjobave të PZAP-it.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.328/2019 më datë 07.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 1 c) të LZP-së.